

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, nenit 50.1 shkronja I) të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

PROPOZIM V E N D I M PËR APROVIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT 2021-2023

I.

Kryetari i Komunës i PROPOZON Kuvendit të Komunës së Vitisë që ta shqyrtoj dhe aprovoj Planin e Integritetit për Komunën e Vitisë 2021-2023

II.

Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi është Plani i Integritetit për Komunën e Vitisë 2021-2023.

III.

Për zbatimin e këtij propozim vendimi dhe Planit të Integritetit për Komunën e Vitisë 2021-2023 do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë.

IV.

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

PROPOZUES: KRYETARI I KOMUNËS
Sokol Haliti





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

**PROPOZIM PLANI I INTEGRITETIT PËR
KOMUNËNE VITISË**

2021 - 2023

Viti. Mars 2021

Grupi punues i Komunës së Prishtinës

- Sokol Haliti - Kryetar i Komunës
- Skender Ahmeti – Drejtor i Inspeksionit
- Ibrahim Rama – Drejtor I Zhvillimit Ekonomik dhe Financave
- Ajet Sallahu – Drejtor I Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
- Majlinda Ostrogllava – Drejtore për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi
- Nexhmedin Jakupi – Drejtor I Shërbimeve Publike
- Arlinda Sahiti – Drejtore për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
- Fadil Abazi – Menaxher I Zyrës së Prokurimit
- Besim Lubishtani – Zyrtar i Personelit
- Elmaz Zeqiri – Auditor I Brendshëm
- Ibadete Hyseni – ZBGJ dhe ZMD

Përbajtja

Deklarata për integritet.....	6
Plani për integritet	8
Objektivat strategjike, linjat e aktiviteteve dhe masat.....	11
<i>Objektiva strategjike 1:.....</i>	12
<i>Objektiva strategjike 2:.....</i>	18
<i>Objektiva strategjike 3:.....</i>	27
<i>Objektiva strategjike 4:.....</i>	30

DEKLARATA PËR INTEGRITET

Integriteti është dimension jetik i qeverisjes lokale, në mënyrë që ajo të bëhet ashtu siç duan ta kenë qytetarët e Vitisë dhe me qëllimin që t'i besojnë asaj: një qeveri demokratike, të hapur, transparente, efektive dhe efikase. Aktualisht, përmes politikave dhe masave të të marra, Komuna po bën përpjekje të fuqishme për të rritur efikasitetin, trajtimin dhe cilësinë e shërbimeve publike dhe kështu, në mënyrë të dukshme dhe të konsiderueshme, po përmirëson kushtet e jetesës dhe të biznesit për komunitetin lokal.

Ne jemi të ndërgjegjshëm përshkallën dhe kompleksitetin e korruptionit dhe të çështjeve të integrimit me të cilat përballemi ne si komunë. Për shkak të fushës së gjerë të ofrimit të shërbimeve dhe të shpenzimeve komunale, ekziston një potencial serioz për ushtrim të parregullt të pushtetit të monopolit të cilin ne duhet ta menaxhojmë me llogaridhënie, me përgjegjësi dhe me efikasitet. Gjithashtu, qeveria komunale shërben për të lidhur më shumë ofertat e shërbimeve me nevojat lokale, që u lejon zyrtarëve lokalë të ushtrojnë diskrecion më të madh. Kjo kërkon monitorim dhe kontroll më të rrepta. Së treti, ne si qeveri lokale, japim më shumë llogari direkte para elektoratit tonë – sepse lidershipi komunal është zgjedhur direkt nga qytetarët. Secili nga këta tre elementë – përkatesisht potenciali përfundimtar i diskrecionit nga zyrtarët publikë dhe llogaridhënia politike lokale – kanë ndikim mbi korruptionin lokal.

Ne gjithashtu e kuptojmë mirë mandatin tonë për ta luftuar korruptionin lokal. Qytetarët dhe bizneset presin që Komuna e Vitisë, duke patur përgjegjësinë e fundit për të sigurur qasjen, cilësinë, barazinë dhe efektivitetin e shërbimeve publike që ofrohen në nivel lokal, të veprojë në mënyrë efektive si një shtyllë e antikorruptionit dhe shtytëse e vërtetë e reformave për integritet. Reduktimi i mundësive për korruption dhe rritja e efektivitetit të shpenzimeve publike rezulton në mënyrë të padashimtë në shërbime të përmirësuara, më shumë transparencë dhe llogaridhënie, pjesëmarrje të shtuar të palëve të interesit në jetën dhe në të ardhmen e komunitetit dhe me shumë gjasë në më shumë besim.

Duke patur parasysh sa u tha më lart, Komuna është e vendosur të ruajë çdo herë “tolerancën zero” ndaj korruptionit, kur ai zbulohet dhe të sigurojë se ai korruption, mashtrim, keq administrim apo çdo shkelje tjetër e integrititetit apo e ndonjë natyre të ngjashme nuk do të tolerohet. Të gjitha shkeljet e

mundshme do të hetohen, dhe ndaj atyre që janë përgjegjës do të merren masa. Këtu hyjnë edhe ngritja e akuzave penale, veprimit civil ose administrativ dhe korrigjime sipas nevojës.

Është përgjegjësi e të gjithë stafit tonë që të gjitha incidentet e mashtrimit dhe të korrupsionit, apo shkeljet e tjera të integritetit me natyrë të ngashme t'i raportojë tek menaxhmenti mbikqyrës/më i lartë. Një tjetër mënyrë raportimi të bëhet përmes paraqitjes së informacionit përmes mekanizmit të caktuar për paralajmërim. Këto do të trajtohen me konfidentialitetin më të thellë dhe nuk do të zbulohen apo diskutohen me palë të tjera përveç atyre që janë ngarkuar me hetimin e këtyre raportimeve.

PLANI PËR INTEGRITET

Plani për Integritet është një dokument *strategjik*, që konsiderohet si një mjet i rëndësishëm parandalues për fuqizimin e integritetit institucional. Nga Komuna e Vitisë. Ai kuptohet si një respektim strikt i vlerave morale, standardeve profesionale dhe i rregullave të zbatueshme normative. Gjithashtu, Plani është dokument *operativ*, që ofron masa të mbështetura tek riku për të arritur objektivat e integritetit të Komunës.

Plani pritet që të kontribuojë në mënyrë domethënëse në:

- Rritjen e gjasave që Komuna të arrijë objektivat e veta organizative duke vënë në përdorim menaxhimin e riskut të integritetit që është proaktiv dhe jo reaktiv;
- Mbajtjen e fokusit tek prioritetet, në bazë të identifikimit të riskut në bazë të informatave dhe të vlerësimit që do ta ndihmojnë Komunën të shpërndajë në mënyrë efektive burimet e disponueshme kundër korruptionit në mënyrë që të shfrytëzohen në mënyrën më mirë të mundshme;
- Përmirësimin e kontrolleve operative ndaj shkeljeve të integritetit që të rritet efektiviteti, efikasiteti dhe transparenca e të gjitha proceseve, përfshirë edhe ofrimin e shërbimeve;
- Mbajtjen e një sistemi për të arritur respektimin e kërkesave dhe standardeve relevante ligjore dhe procedurale;
- Krijimin e një mjeti të brendshëm që mbështet antikorruptionin përmes **trajnimeve** të duhura dhe ngritisë së ndërgjegjësimit; si dhe përmes inkurajimit të pjesëmarrjes së të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, implementimit dhe monitorimit të planeve të integritetit;
- Rritjen e mëtejshme të besimit të palëve të brendshme dhe të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstrohet nga Komuna.

Së fundmi, ne besojmë se duke implementuar këtë Plan, Komuna e Vitisë është në pozitë më të mirë për të sigruar efikasitet, efektivitet, transparencë dhe etikë gjatë arritjes së rezultateve të synuara, përfshirë këtu shërbime më të përmirësuara për publikun dhe rritje të kënaqshmërisë nga ana e palëve të interesit. Ne e konsiderojmë këtë Plan si fillimin e një rrugëtimi afatgjatë dhe që synon *një sistem menaxhimi integriteti funksional (më tutje: SMI)*. Është sistemi, dhe jo elementet e izoluara, ai që konsiderohet të jetë kryesor i për të reduktuar kostot e prapambetura ekonomike dhe njerëzore të shkeljes së integritetit, për të vënë në zbatim përmirësimin e vazhdueshëm organizativ,

për të rritur reputacionin dhe besueshmërinë.

Plani mbështetet në *rezultatet e një planifikimi gjithpërfshirës për integritetin dhe të një procesi vlerësimi të riskut* që Komuna e Vitisë e ka bërë edhe më herët në Planin paraprak 2017 - 2020. Procesi ka përfshirë *identifikimin e pikave të dobëta të organizatës* në rastet e shkeljeve të integritetit dhe *vlerësimin e tyre* duke marrë parasysh (1) dëmet materiale dhe jomateriale që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe (2) gjasat që këto ngjarje

ndodhin më parë nga rezistenca aktuale organizative e vërtetuar nga rregulloret, procedurat, kodet, praktikat relevante dhe nga përfshirja e stafit.

Për të arritur këtë, Komuna ka ndërmarrë veprimet në vijim:

- Ka rishikuar kornizën relevante të strategjive rregullative dhe operative, d.m.th. planin për zhvillim institucional, Strategjinë për qeverisje locale (që përputhet me Ligjin për Qeverisje Lokale) etj;
- Ka analizuar të dhëna nga performanca e integritetit, monitorimi dhe implementimi (duke raportuar dy here në vit në Kuvendin e Komunës për zbatimin e Planit paraprak)
- Ka analizuar kënaqshmérinë dhe perceptimin e klientëve për korrupsion në qeverisjen lokale përmes anketimeve dhe raporteve të kërkua nga organizata ndërkombëtare dhe vendore siç është MPB
- Ka zhvilluar një mjet referues për vetëvlerësimin e organizatës që të ofrojë informacion dhe të dhëna të dobishme për vlerësimin e sisitemit të menaxhimit të integritetit në Komunë, të analizuar në bazë të rezultateve, fushave të perceptuara të riskut dhe fushave të identifikuara për përmirësim (është zhvilluar korniza për vetëvlerësimin e integritetit të organizatës);
- Ka përdorur seanca pune për diskutim të ideve, intervista të strukturara me personel kryesor dhe konsultime me stafin si teknika për të identifikuar dhe vlerësuar risqet ndaj integritetit dhe për të renditur masat parandaluese (është evidentuar Regjistri i Risqeve të Integritetit);
- Ka përdorur modele të ndryshme të Planit të integritetit të punuara nga organizatat ndërkombëtare, si UNDP e të tjera

Tani, pasi e kemi kaluar identifikimin e riskut të integritetit, procesin e vlerësimit dhe planifikimit, ne besojmë se ka qenë procesi dhe jo masat konkrete të zhvilluara ato që kanë patur më së shumti vlerë për ne dhe organizatën tonë. Planifikimi i integritetit ka kontribuar në të nxenit organizativ dhe ka ofruar një platformë për të diskutuar risqet dhe për të marrë vendime në bazë të organizatave si UNDP e të tjera, se si të shfrytëzohen më së miri kontrollet ekzistuese.

Duke patur parasysh si u tha më lart, ne e konsiderojmë Planin e Integritetit jo si një dokument statik, por si një dokument zbatues, që do të vlerësohet dhe azhurnohet sipas nevojës.

Në bazë të *Planit të Veprimit* që është zhvilluar dhe gjendet në shtojcë (Shtoja 1) do të caktohet edhe buxheti special për implementimin e Planit të Integritetit.

Implementimi i tij do të monitorohet me format të planifikuar, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale

procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të organizatës. *Monitorimi i vazhdueshëm i implementimit* është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i riskut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive në dizajn dhe funksionim; se procedurat kuptohen dhe se plani i integritetit përcillet. Në vijim të kësaj, monitorimi gjithashtu duhet të përcaktojë nese masat e përdorura për trajtimin e riskut kanë prodhuar efektet e planikuara; kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e brendshëm dhe të jashtëm përfshirë ndryshimet e vetë riskut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioriteteve të riskut; kanë identifikuar cilat mësime duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Përgjegjësitë për monitorimin e rregullt të Planit i janë caktuar: Burim Sadikut – zyrtar ligjor

Raportimi i rregullt siguron se implementimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planikuara janë arritur. Burim Sadiku, do të jetë përgjegjës për të raportuar në baza periodike tek Kryetari i Komunës së Vitisë për progresin e implementimit. Frekuenca minimale e raportimit është brenda periudhës gjashtë mujore. Raportimi i lejon Kryetarit të Komunës të ndërmarrë me kohë masa përmirësuese/parandaluese në rast se implementimi i ndonjë mase/masave të caktuara sjell vështirësi/vonesa.

Në veçanti, Plani i Integritetit përbën:

- **Planin e Integritetit:** shpjegon fushëveprimin, qëllimin, objektivat dhe metodologjinë që është përdorur për të zhvilluar Planin e Integritetit. Paraqet aspektet kryesore të procedurave relevante për implementim, monitorim dhe raportim.
- **Objektivat strategjike, linjat e aktivitetit dhe masat:** paraqesin objektivat kryesore strategjike dhe bën përbledhjen e fushave të veprimit që synojnë të fuqizojnë mbrojtjen e integritetit në Komunën e Vitisë në bazë të risqeve të vlerësuara të integritetit, mësimeve të nxjerra dhe praktikave të mira relevante. Plani ofron arsyetime të shkurtra për linjat e planikuara për veprim, të mbështetura nga masa të targetuara që të udhëheqin procesin e implementimit.
- **Plani i Veprimit:** paraqet me hollësi të gjitha masat që do të merren për të arritur objektivat e caktuara, si dhe kornizën kohore relevante dhe përgjegjësitë organizative për implementim. Janë përcaktuar indikatorët e suksesit për secilën masë që mbështeten nga burimet-financat e nevojshme.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE, LINJAT E AKTIVITETEVE DHE MASAT

Progresi aktual i Komunës së Vitisë, si dhe zotimi i menaxhmentit të lartë dhe përfshirja e stafit ofrojnë bazë të shëndoshë për avancimin e menaxhimit të integritetit në vitet e ardhshme. Duke ecur përpara, Komuna do të fuqizojë masat që rrisin integritetin dhe parandalojnë korrupsionin duke u fokusuar te katër fushat kryesore në vijim:

- Efikasitet, efektivitet dhe transparencë e rritur në sistemin e përgjithshëm të menaxhimit të komunës përmes integritimit të menaxhimit të riskut të integritetit si element thelbësor i përgjegjësisë menaxhuese për të kontrolluar risqet e integritetit dhe korrupsionit;
- Efikasitet, efektivitet, cilësi dhe transparencë e rritur e operacioneve të komunës përmes shfrytëzimit më të mirë të kontolleve të integritetit në nivel operativ;
- Kornizë e zgjeruar e burimeve njerëzore që çon në dhe mbështet reformat për integritet, menaxhon sistemin e integritetit dhe implementimin e objektivave/masave për integritet përmes përmirësimit të dukshëm të aspekteve të integritetit të funksionit të SMBNJ dhe DBNJ;
- Mundësimi i mjedisit të jashtëm për të promovuar modernizimin dhe për të ruajtur zotimin kolektiv për integritet përmes koordinimit më të mirë me palët e interesit, shtimit të ngjarjeve për ndërgjegjësim dhe komunikim, rritjes së transparencës dhe angazhimit qytetar dhe shpërndarjes së praktikave të mira.

Në vijim paraqiten dhe shpjegohen objektivat e lartpërmendura strategjike dhe këto objektiva përkthehen në linja të aktiviteteve konkrete të politikave dhe menaxhimit dhe në masa që përkrahin arritjen e tyre.

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 1:

Rritje e efikasitetit, efektivitetit dhe transparencës në përgjithësi të sistemit të menaxhimit komunal përmes integrimit të riskut të integritetit si element thelbësor i përgjegjësisë menaxhuese për të menaxhuar risqet e integritetit dhe korrupsionit

Linjat e aktivitetit dhe masat përkatëse

- 1.1. Shndërrimi i planifikimit të integritetit në praktikë të qëndrueshme dhe me burime të duhura që synon gjetjen e përdorimit më të mirë të burimeve në dispozicion për anti-korrupsion në bazë të vlerësimit të riskut në mënyrë sistematike dhe me anë të informatave.

Arsyetimi: Aktualisht, Komuna e Vitisë po kalon nëpër një proces të strukturuar të planifikimit të integritetit. Mirëpo ky proces do të ketë sfida. Për të siguruar qëndrueshmëri, Komuna do të bëjë përpjekje të tjera të vazdueshme për të fuqizuar kapacitetet e brendshme për planifikim dhe menaxhim të integritetit; do të ofrojë monitorim dhe raportim të rregullt gjatë implementimit, si dhe rivlerësim periodik. Planifikimi i integritetit do të bëhet me burimet e duhura dhe do të jetë pjesë e praktikave rutinore të menaxhimit.

Masat:

- 1.1.1. Të komunikohet Planit i Integritetit aktual tek i gjithë stafi, përfshirë ndarjen e përgjegjësive lidhur me implementimin e tij dhe afatet përkatëse.
- 1.1.2. Të fuqizohen kapacitetet e të gjithë stafit për të kuptuar çështje të integritetit dhe për të implementuar masat e integritetit përmes trajnimit gradual, të targetuar për integritet dhe rritjes së vetëdijësimit. Fokusimi tek menaxhmenti i lartë dhe i nivelit të mesëm që ushtrojnë ndikim strategjik mbi ndryshimin e efikasitetit të organizatës.
- 1.1.3. Të zhvillohet një qasje sistematike për të monitoruar, vlerësuar dhe komunikuar së brendshmi rezultatet e implementimit të masave të integritetit, përfshirë raportimin për masa të integritetit si pjesë e raporteve vjetore të menaxhmentit. Të caktohen përgjegjësitë e nevojshme për të reportuar implementimin e masave anti-korrupsion. Të shfrytëzohet në maksimum mundësia për të komunikuar rezultatet e

implementimit te një shkallë të gjerë të palëve të interesit përmes formave të duhura të komunikimit: publikim në uebfaqe, mbledhje etj.

- 1.1.4. *Të merren masa se risqet e integritetit rivlerësohen në intervale të planifikuara, d.m.th. rishikime periodike të aktiviteteve të njësive me funksione kontrolli në fushat ku ka risqe më të mëdha dhe ku është e nevojshme.*

1.2. Progresivisht të arrihet tranzicioni nga planifikimi i integritetit drejt një sistemi funksional të menaxhimit të integritetit që do të fuqizonte rezistencën e përgjithshme organizative të komunës ndaj korrupsionit, minimizimin e niveleve të mbeturat të riskut dhe parandalimi efektiv nga shkeljet e integritetit.

Arsyetimi: Planifikimi i integritetit është *hapi i parë* drejt menaxhimit efektiv të riskut të integritetit. Për të patur një sistem funksional të menaxhimit të integritetit, kërkon që Komuna të implementojë në tërësi kornizën e përmirësimit të vazhdueshëm Planifikim - Bërje - Kontrollim - Veprim (PBKV) dhe të përfshijë menaxhimin e integritetit në praktikat rutinore të menaxhimit. Kjo kërkon që (1) të **planifikojë** politikat e ndërlidhura me integritetin, kodin e etikës dhe planin e integritetit; (2) të **implementojë** masat e planit dhe kontrolllet e ndërlidhura operative; (3) të **kontrollojë**, monitorojë dhe masë karakteristikat kryesore të punës që përcaktojnë performancën organizative lidhur me parandalimin e korrupsionit dhe të integritetit kundrejt politikave dhe objektivave të integritetit dhe të raportojë rezultatet; dhe (4) të **ndërmarrë hapa** për të përmirësuar vazhdimisht performancën e integritetit organizativ dhe sistemin e menaxhimit të integritetit.

Masat:

- 1.2.1. Të bëhet ndarja e përgjegjësive të qarta sa i përket planifikimit, implementimit, monitorimit dhe përmirësimit të sistemit të menaxhimit të integritetit (SMI). *Komunikimi* efektiv i tyre tek i gjithë stafi;
- 1.2.2. Të ndërmerr komunikimi i brendshëm efektiv dhe i strukturuar lidhur me korrupsionin dhe integritetin në të gjitha funksionet dhe nivelet brenda organizatës. Të integrohen aspektet e integritetit në politikat/praktikat e komunikimit të brendshëm.
- 1.2.3. Të bëhet prezantimi i një sistemi që mundëson *raportim konfidencial* të shkeljeve të integritetit, përfshirë shkeljet e ligjit ose të standardeve ose të etikës profesionale, në mirëbesim dhe mbi baza të arsyeshme. Për këtë qëllim, të miratohet *Politika e paralajmérimit të Komunës së Vitisë*, që paraqet procedurën e hollësishme, e cila duhet të ndiqet për të raportuar incidente të mashtrimit dhe/ose korrupsionit. Kjo politikë të respektojë dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-043 për mbrojtjen e informatorëve, që udhëheq mbrojtjen e paralajmëruarve në Kosovë. Kjo politikë do të komunikohet në të gjitha nivelet, për të përkrahur njojuri adekuate rrëth tij, qëndrime pozitive dhe zbatimin efektiv.
- 1.2.4. Të krijohet një *monitorim i brendshëm i performancës së integritetit* të strukturuar për Komunën brenda intervaleve të

planifikuara (d.m.th. çdo tre muaj) që të mundësohet se rezultatet raportohen tek menaxhmenti i lartë dhe se ndërmerren masat e duhura përmirësuese;

- 1.2.5. *Të krijohet rishikimi i sistemit të menaxhimit të integritetit – për të rishikuar brenda intervaleve të planifikuara* (p.sh. çdo vit) të dhënat për burime lidhur me performancën e SMI (d.m.th. implementimin e objektivave dhe të masave,

rezultateve nga monitorimi i performancës së integritetit, rezultateve të auditimit të brendshëm, sfidave dhe rekomandimeve për përmirësim etj.) dhe për të marrë vendime lidhur me efektivitetin e shtuar të SMI.

1.3. Në mënyrë progresive të integrojë aspekte të Sistemit të Menaxhimit të Integritetit në sistemet e menaxhimit të cilësisë organizative në përputhje me qasjen MCT dhe me praktikat relevante të menaxhimit të mirë.

Arsyetimi: Instrumentat e bazuara tek MCT kanë dëshmuar efektin e tyre në rritjen e qeverisjes së sektorit publik në shumicën e vendeve të BE-së, pasi ato mbështesin parimin e përmirësimit të vazhdueshëm në të gjitha punët, që nga niveli i lartë i planifikimit strategjik dhe vendimmarraja, deri në zbatimin me hollësi të elementeve të punës në nivel operativ përmes përmirësimit të aftësive, të njerëzve, proceseve, teknologjisë dhe të infrastrukturës. Tipari i tyre dallues është Fokusi tek Klienti që do ta ndihmojë Komunën e Vitisë të përmirësojë marrëdhënien e shërbimit me klientët e brendshëm, cilësinë e shërbimeve, standardet e udhëhequra nga klientët, marrëdhëniet me furnitorët/nënkontraktorët.

Masat:

- 13.1. *Të përdoret gjithnjë e më shumë një sistem i menaxhimit të cilësisë i orientuar nga procesi dhe zgjerimi i fushëveprimit të tij për të mbuluar të gjithë Komunën, në përputhje me praktikën më të mirë të Shteteve Anëtare të BE-së dhe në përputhje me standarde të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë. Kjo do të përmirësojë cilësinë dhe transparencën e shërbimit, llogaridhënieve dhe - përcjelljes, si dhe në marrëdhënie me furnitorët. Në disa departamente komunale, janë ndërmarrë hapa për të prezantuar një sistem të mbështetur tek menaxhimi i procesit. Për të mundësuar efektin e*

- përshkallëzimit, duhet planifikuar zgjerimi i fushëveprimit të sistemit, burimeve dhe vazhdimi i implementimit të këtij plani.
- 132 Të zhvillohet një regjistër i plotë dhe gjithëpërfshirës i proceseve të Komunës. *Mbulimi i të gjitha proceseve kryesore* që janë të rëndësishme për cilësinë dhe integritetin përmes *procedurave të brendshme operative* të

dokumentuara si duhet për të reduktuar riskun nga gabimet dhe devijimet. *Komunikimi i këtyre procedurave tek i gjithë stafi në mënyrë që të hyjnë në përdorim në mënyrë efektive.* Trajnim i stafit sipas nevojës.

133. Të zhvillohen *indikatorët e duhur operativë, menaxherialë dhe të performancës strategjike* të të gjitha proceseve komunale që mundësojnë vlerësimin e progresit të ndikimit të reformës, identifikimit të problemeve, përkrahjes së vendimmarrjes/proceseve operative etj. Nëse është e mundur, të krijohet një sistem i automatizuar për të monitoruar indikatorë të specifikuar të performancës.
134. Të përdoren komentet nga përdoruesit e shërbimit si instrument për të rritur performancën e integritetit të organizatës dhe cilësinë e shërbimit. Për këtë qëllim, të planifikohen dhe të implementohen anketa të kënaqshmërisë së klientëve; kontolle ad hoc, operacione me klientë sekretë etj.

1.4. Në përputhje me ngritjen e sistemeve të forta të menaxhimit të cilësisë dhe integritetit, të zbatohet në vijimësi koncepti i shërbimit të orientuar nga klienti duke zhvilluar një Statut të Shërbimit të Klientit që përshkruan nivelin minimal të shërbimit që klienti duhet të presë nga Komuna e Vitisë dhe të sigurojë fokus të vazhdueshëm tek klienti gjatë punës rutinë.

Arsyetimi: Statuti i Shërbimit ndaj Klientit do të përshkruajë nivelin minimal të shërbimit që klienti duhet të presë nga Komuna me terminologji të qartë dhe gjuhë të thjeshtë. Statuti i informon klientët si të bëjnë parashresa ose sugjerime (përfshire, nëse është me vend, forma të përmirësimit/ankesës nga jashtë) dhe të përfshijë hollësitë kontaktuese. Ai demonstron zotimin ndaj standardeve të shërbimit dhe mbështet vlerësimin e vazhdueshëm të performancës me raportim të hapur të rezultateve. Mund të kontribuojë dukshëm në ngritjen e imazhit të Komunës si një organizatë që ka standarde të larta dhe përkushtim të demonstruar ndaj cilësisë dhe transparencës së shërbimit publik.

Masat:

- 1.4.1. Të rizbatohet koncepti i shërbimit të orientuar nga klienti duke zhvilluar *Statutin e Shërbimit për Klientin të Komunës së Vitisë* në përputhje me përpjekjet për modernizim të Komunës dhe

praktikat e mira në dispozicion. Këtu përfshihet edhe zotimi për të ruajtur ekselencën profesionale dhe standardet e larta të sjelljes, të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, informacion në kanalet në dispozicion për ankesa, përgëzime dhe komente për të krijuar një të kuptuar më tërësor të ndërveprimit mes zyrtarëve publikë dhe qytetarëve.

142. *Të bëhet paraqitja e Statutit të Shërbimit të Klientit në zonat kryesore publike (p.sh. zonat ku ofrohen shërbimet) dhe ofrimi i qasjes në të përmes medias së shtypur dhe elektronike dhe ubefaqes.*
143. *Të vihet në dijeni i gjithë stafit lidhur me standartet e shërbimit që gjenden në Statut.*

1.5. Për t'u sigruar më mirë se risqet kritike të integritetit që janë të ndërlidhura me asete të sigurisë së informacionit menaxhohen me efektivitet, duhet azhurnuar çdo herë sistemi për menaxhimin e sigurisë së informacionit që aktualisht është funksional në Komunë për të arritur shkallë më të lartë të pajtueshmërisë me praktikat e mira në dispozicion dhe standartet relevante, sidomos kërkesat për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit

Arsyetimi: Komuna po azhurnon sistemet e veta të menaxhimit të informacionit që ofrojnë avantazhe të konsiderueshme, mirëpo kërkojnë dhe theks më të fuqishëm tek siguria e informacionit dhe integritetit. Duke patur parasysh shtrirjen e sistemit të informacionit dhe mundësitet për të dëmtuar palët e treta, sjellja etike duhet të promovohet në atë mënyrë që të njohë nevojat për siguri dhe të respektojë interesat legjitimë të të tjera. Mbrotja e informacionit personal dhe mbrotja e informacionit konfidencial është me rëndësi shumë të madhe. Praktikat e mira (p.sh. Udhëzuesit e Sigurinë e Informacionit dhe Rrjetet dhe standardi i menaxhimit ISO/IEC 27001) sugjerojnë se të gjithë janë përgjegjës për sigurinë e informacionit. Për këtë qëllim do të merret parasysh detyrimi për të dhënë deklaratën e konfidencialitetit dhe mosbulimit të informatave zyrtare. Vlerësimi i riskut, dizajni i sigurisë, menaxими i sigurisë dhe rivlerësimi janë përbërës integralë të sistemit të shëndoshë të sigurisë së informacionit. Për të garantuar rezultate, aplikimi i sistemit duhet të kontrollohet, monitorohet në mënyrë strikte dhe të auditohet rregullisht.

Masat:

- 15.1. Të zhvillohet Doracaku për Sigurinë e Integritetit dhe Sigurinë e Informacionit në Komunën e Vitisë në bazë të Udhëzuesve të për Sigurinë e Informacionit si dhe Rrjetet dhe standardin e menaxhimit ISO/IEC 27001 dhe integrimi i saj në politikat aktuale për sigurinë e informacionit;
- 15.2. Sipas nevojës të sigurohen burime për procesin e menaxhimit të sigurisë së informacionit përmes krijimit/fuqizimit të kapaciteteve komunale për menaxhimin e sigurisë së informacionit

- (p.sh. trajnime për staf të përzgjedhur)
- 153 Të zhvillohet një *vlerësim i zbrazëtirave* të sistemit të menaxhimit të informacionit ekzistues kundrejt *ISO/IEC 27001* që përkufizon kërkesat për krijimin, implementimin, operimin, monitorimin, rishikimin dhe përmirësimin e një Sistemi të Menaxhimit të Sigurisë të dokumentuar. Në bazë të rezultateve, *të krijohet dhe implementohet një Plan Veprimi i ndarë në*

faza për Sigurinë e Informacionit me masa konkrete për të sigruar përzgjedhjen e kontrolleve të sigurisë të përshtatshme dhe proporcionale që mbrojnë asetet e informacionit, rrisin besueshmërinë organizative para palëve të interesit dhe parandalojnë shkeljet e integritetit.

154. Të merren masa që të gjithë punonjësit sensibilizohen rregullisht lidhur me riskun nga mashtrimet dhe korrupsioni që kanë të bëjnë me sigurinë e informacionit dhe shfrytëzimin e burimeve kompjuterike, sidomos - kontrolli i qasjes dhe marrja e masave që të zhvillohen sisteme, të cilat kufizojnë riskun nga manipulimi i të dhënavë të kompjuterizuara. Për këtë qëllim, *të krijohet një sistem i rregullt i trajnimeve/eventeve përvetëdijësim/kanaleve të mentorimit.*

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 2:

Rritje e efikasitetit, efektivitetit, cilësisë dhe transparencës së operacioneve komunale përmes kontolleve të optimizuara të integritetit në nivel operativ

Linjat e aktivitetit dhe masat përkatëse

2.1. Fuqizimi i rregullave/praktikave në fushat kryesore të mbrojtjes së integritetit: konflikti i interesit, performanca jashtë punës, deklarimi i aseteve, dhuratave dhe akomodimit dhe marrja e masave se këto rregulla janë kuptuar mirë dhe ndiqen

Arsyetimi: Rregulla të qarta të brendshme për kontrollet e integritetit janë kritike për menaxhim efektiv të integritetit. Ato duhet të janë në pajtim me kornizën ligjore aktuale si dhe me standardet më të mira të integritetit që janë në dispozicion. Niveli i mjafueshëm i njojurisë së këtyre rregullave nga i gjithë stafi është absolutisht i nevojshëm për të siguruar implementim efektiv.

- 2.1.1. Të rishikohet nevoja për të zhvilluar rregulla të brendshme për deklarimin e interesit, performëncës jashtë punës, deklarimit të aseteve, dhuratave dhe mikpritjes përvèç Kodit të Sjelljes dhe rregulloreve të zbatueshme vendore. Këto rregulla të zhvillohen nëse konsiderohen të nevojshme dhe/ose të modifikojnë Kodin ekzistues për të mbuluar të gjitha fushat e mbrojtjes së integritetit.
- 2.1.2. Të merren masa për nivel të mjafueshëm të njojurisë së të gjithë stafit për rregullat ekzistuese për konfliktin e interesit, performancës jashtë punës, deklarimit të aseteve, dhuratave dhe mikpritjes përmes trajnimit të duhur dhe eventeve për rritje të vetëdijësimit.
- 2.1.3. Të krijohet *registri i dhuratave* në Komunën e Vitisë në përputhje me rregulloret relevante (Kapitulli III (Dhuratat) i Ligjit Nr. 04/L-050 për deklarimin, originën dhe kontrollin e dhuratave të të gjithë zyrtarëve publikë). Të merren masa që stafi të jetë në dijeni të Regjistrat dhe së ky i fundit të mbahet si duhet.

**2.2. Rritja e rezistencës ndaj shkeljeve të integritetit përmes fuqizimit të
kontolleve operative për integritetin në proceset e prokurimit publik**

Arsyetimi: Prokurimi publik është një sektor me risk e kompleksitet të lartë ku sektori privat-publik ndërveprojnë direkt dhe krijon mundësi shumë të mira për përfitime. Korrupsioni në prokurim përfshin humbje fiskale, humbje të efikasitetit nga prishja e

konkurrencës në treg dhe humbje të mirëqenies lidhur me qasje të përkeqësuar dhe të cilësisë së shërbimeve dhe mallrave publike. Në Kosovë, ashtu si në shumë Shtete Anëtare të reja të BE-së, risqet nga prokurimi në korrupsion i mvishen krizës relativisht të re dhe në rritje të shpejtë të krizës së prokurimit, ku shumë kontolle operative të integrititetit ende nuk kanë arritur të zbatohen në mënyrë efektive. Fuqizimi i këtyre kontolleve shndërrohet në një element jetësor për menaxhimin e integrititetit.

- 2.2.1. *Në përputhje me rregulloret vendore, të zhvillohen dhe të zbatohen standardet minimale për transparencë në prokurimin publik në Komunën e Vitisë, si një kufi dhe të monitorohet implementimi i tyre. Transparency është thelbësore sa i përket mundësive për tendera, kritereve të përzgjedhjes, procesit të vlerësimit, vendimit për dhënie kontrate dhe arsyetimit të tij, afateve dhe kushteve të kontratave dhe të gjithë arsyetimeve të tyre, zbatimit të kontratës, kontesteve dhe mekanizmave dhe procedurave për zgjidhje.*
- 2.2.2. Të fuqizohen kapacitetet për të menaxhuar prokurimin publik përmes krijimit dhe implementimit të një programi të *zhvillimit të vazhdueshëm profesional* për zyrtarët për prokurim publik (me fokus te standardet dhe integriteti profesional).
- 2.2.3. Aty ku është e realizueshme, të zbatohet *ndarja e detyrave në fazat kyçë të prokurimit publik* – kuotimet, dhënet e kontratave, mbikëqyrja e implementimit të kontratave, pranimet dhe pagesat.
- 2.2.4. Aty ku është e realizueshme, të praktikohet *rotacioni i rregullit i stafit* në njësinë e prokurimit publik dhe kontratave për të shmhangur mundësinë që të krijojen apo forcohen marrëdhënie potenciale korruptive.
- 2.2.5. Të krijohet mundësia për *zbatim* të vazhdueshëm *të rregulloreve* në procesin e prokurimit publik. Të kërkohet nga të gjithë pjesëtarët e Komisionit të Tenderave që të nënshkruajnë formularin e Deklarimit të Interesit.
- 2.2.6. Të sigurohet *mbikëqyrja efektive e qytetarëve* mbi procesin e prokurimit publik me anë të ruajtjes së kërkkesave që komisionet përzgjedhëse që i përzgjedhin tenderat fitues të kenë në përbërje staf të qeverisë lokale dhe vëzhgues nga OJQ të pavarura. Kjo do të hapë procesin dhe siguron se procesi po zhvillohet me legjimititet.
- 2.2.7. Të fuqizohen kontrolllet operative gjatë *pranimit dhe procesimit të dokumentacionit të tenderave*: Dosjet e tenderave të pranohen së paku nga dy persona ose të vendosen në kutinë e tenderit. Kutia e Tenderit duhet të jetë gjithnjë e myllur dhe tenderat e dorëzuar duhet të merren nga dy pjesëtarë të stafit të autorizuar

posaçërisht për këtë – asnëjëri prej tyre nuk duhet të ketë mundësinë të hapë kutinë e tenderit vetëm. Të gjithë tenderët e pranuar duhet të regjistrohen dhe të arkivohen për qëllime dokumentacioni me tenderuesin e suksesshëm dhe me rezultatin vijues nga vlerësimi.

- 2.2.8. Të kufizohen mundësitë për *komunikim me ofertuesit* duke krijuar protokoll të qartë për komunikimin me ofertuesit dhe duke krijuar pika të qarta të kontaktit për ofertuesit. Vetëm një numër i vogël i zyrtarëve të kenë mundësinë të merren direkt me ofertuesin.

- 2.2.9. Të inkurajohen kompanitë që punojnë me Komunën të vërtetojnë se ato i respekojnë zotimet për integritet të Komunës dhe dispozitat vendore anti-korrupsion dhe të kërkohet prej tyre që përvëç kontratës të nënshkruajnë edhe këto deklarata zotimi.
- 2.2.10. Të miratohet dhe mbahet një listë e zezë e furnitorëve/nënkontraktorëve që nuk respekojnë standartet e brendshme të integritetit të përcaktuara nga Komuna për të udhëhequr vendimet potenciale të përjashtimit.
- 2.2.11. Të zhvillohen indikatorë të performancës së prokurimit për të monitoruar dhe për të përmirësuar performancën e prokurimit me kalimin e kohës; p.sh. numri i ankesave, koha mes hapjes së ofertës dhe dhënieve së kontratës, numri i ndryshimeve në kontratë, rritjet e çmimit etj.
- 2.2.12. Të caktohen auditime pas prokurimit dhe dhënieve së kontratës për tenderë mbi një kufi të specifikuar për të rishikuar respektimin e standardeve të specifikuara procedurale.

2.3. Përmirësimi i rezistencës organizative ndaj shkeljeve të integritetit në fushat kryesore operative të ofrimit të shërbimeve

Arsyetimi: Komuna do të përdorë kontolle operative për të menaxhuar risqet madhore të identikuara të integritetit, të sigurojë respektimin e kërkesave ligjore dhe të shmangë ose minimizojë risqet e integritetit. Kur identifikohen risqet për kontolle operative, Komuna merr parasysh të gjitha veprimet e saj, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me funksione menaxheriale (p.sh. blerja, menaxhimi financiar etj.); dhe të gjitha këto veprimitari kryesore të përditshme. Vlerësimi i riskut të kryer tregon risqet kryesore në kontekst të funksioneve kyçe të Komunës në fushat e: planifikimit urban dhe rural; implementimit të rregulloreve për ndërtim dhe standardeve për kontroll të ndërtimit; shfrytëzimit dhe zhvillimit të tokës; licensimit të shërbimeve dhe hapësirave lokale, përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të zbavitjes, ushqimit, akomodimit, tregjeve, shitësve në rrugë, transportit publik lokal dhe taksive; zhvillimit ekonomik lokal; shëndetit publik; ofrimit dhe mirëmbajtjes së shërbimeve publike, përfshirë furnizimin me ujë, kanalet e ujërave të zeza dhe kanalizimeve, trajtimit të ujërave të zeza, menaxhimit të mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të ngrohjes

lokale. Në mesin e kompetencave të deleguara të Komunës ato që janë më të rrezikuara nga shkeljet e integritetit (të prirura për korrupsion) konsiderohet të jenë dokumentat kadastralë; licensimi dhe regjistrimi i bizneseve; regjistrat civilë; regjstrimi i votuesve; shpërndarja e pagesave të asistencës sociale (përjashtuar pensionet); dhe mbrojtja e pyjeve dhe e territorit të komunës. Përballë këtyre sfidave, Komuna ka identifikuar priorititetet e veta afatshkurtra dhe afatgjata dhe kontrolllet e strukturuara operative në forma të ndryshme si procedura, udhëzime për punë, kontolle fizike, përdorimi i personelit të trajnuar apo kombinimi i tyre. Zgjedhja për metoda specifike të kontrollit varet nga një sërë faktorësh si shkathtësitë dhe përvoja e njerëzve që e kryejnë operacionin dhe domethënia e kompleksitetit dhe integritetit të vetë operacionit.

Masat e përgjithshme

- 2.3.1. Aty ku është e realizueshme, të rritet numri i shërbimeve publike në dispozicion në formë elektronike. Përdorimi i teknologjive informative për të rritur transparencën, cilësinë dhe shpejtësinë e shërbimeve publike.
- 2.3.2. Aty ku është e realizueshme, të krijohet/rritet niveli i shërbimeve që u ofrohen qytetarëve si qendra të shpejta;
- 2.3.3. Të implementohet sistemi elektronik i menaxhimit të dokumentave; ndarja elektronike dhe monitorimi i dokumentave; procesimi elektronik i kërkesave, krijimi i një platforme ndërvepruese elektronike për të siguruar informacion për kërkesat që kanë të bëjnë me statusin e dosjeve.

Kadastra

- 2.3.4. Të ndërmerrin hapa efektivë për të krijuar burimet e duhura përfunksionin e kadastrës me personelin e duhur kompetent.
- 2.3.5. Të merren masa për trajnim të duhur profesional për stafin në drejtorinë e kadastrës, p.sh. trajnim për menaxhimin e integritetit dhe etikës.
- 2.3.6. Të ndërmerrret riorganizim rrënjesor i procesit të punës në zyrat e pranimit - sportelet ku të instalohen kontolle të forta të integritetit
- 2.3.7. Të fuqizohen mekanizmat e kontrollit në zyrat e pranimit - sportelet, përfshirë operacione ad hoc dhe me klientë sekretë
- 2.3.8. Të rritet integriteti në regjistrimin e patundshmërive në departamentin kadastral, të merren masa për të përmirësuar komunikimin mes autoriteteve gjyqësore, AKP, APK dhe drejtorisë së kadastrës
- 2.3.9. Të rritet integritetit në regjistrimin e patundshmërive në departamentin kadastral, të nisë dhe të mbahet një sistem funksional i skanimit dhe arkivimit profesional
- 2.3.10. Të ndërmerrin hapa për të lehtësuar/mbajtur bashkëpunim efektiv mes Odës së Noterëve të Kosovës, Odës së Ekzekutuesve Privatë, gjykatave dhe Ministrite relevante lidhur me regjistrimin e çështjeve të patundshmërive
- 2.3.11. Të krijohen mekanizmat e duhur të kontrollit në fushën e regjistrimit dhe çregjistrimit të hipotekave në departamentin e kadastrës, përfshirë operacione ad hoc dhe me klientë sekretë
- 2.3.12. Të shtohen kontrolllet e integritetit në regjistrimin e ndarjes, bashkimit të ngastrave në departamentin e kadastrës, të rritet bashkëpunimi mes Shoqatës së Ekspertëve të Gjeodezisë së Kosovës

dhe drejtorisë së kadastrës.

2.3.13. Të ofrohet *informacion dhe trajnim i duhur për udhëzimet ose kornizat e reja për matje kadastrale.*

2.3.14. Të fuqizohen/zgjerohen mekanizmat e kontrollit të brendshëm lidhur me regjistrimin e ndarjes, bashkimit të ngastrave në departamentin e kadastrës

Zhvillimi ekonomik lokal dhe bujqësia

2.3.15. Të zhvillohen udhëzues të qartë (p.sh. kritere dhe procedura) për të udhëhequr efektivisht ndarjen e subvencioneve dhe për të parandaluar vendime arbitrale dhe praktika korruptive

- 2.3.16.Të zhvillohen politika strategjike afatmesme dhe planeve të veprimit se si të ndahen mjetet në sektorin e bujqësisë. Të merren masa për monitorim dhe implementim efektiv, raportim periodik dhe komunikim të rezultateve dhe nevojës për masa përmirësuese.
- 2.3.17.Të përmirësohet struktura dhe organizimi i brendshëm i rrjedhës së komunikimit mes sektorëve të zhvillimit ekonomik dhe bujqësisë për të larguar fraksionet dhe për të mundësuar rrjedhë efikase të informacionit.

Planifikimi urban dhe rural

- 2.3.18.Të zhvillohen procedura të brendshme/kritere të qarta të duhura që adresojnë risqet kryesore të integritetit në procesin e planifikimit urban dhe rural dhe parandalojnë vendimet subjektive
- 2.3.19.Të fuqizohet sistemi i planifikimit, të krijohet planifikim afatmesëm për të lidhur prioritetet dhe për të parandaluar vendimet ad hoc
- 2.3.20.Të fuqizohen mekanizmat e kontrollit, p.sh. kontrollet ad hoc në baza shembujsh dhe pas nxjerrjes së auditimeve përcjellëse

Shfrytëzimi dhe zhvillimi i tokës

- 2.3.21.Të zhvillohen procedura të brendshme/kritere të duhura për të adresuar risqet kryesore të integritetit në procesin e shfrytëzimit dhe zhvillimit të tokës dhe që parandalon subjektivizmin
- 2.3.22.Të fuqizohet sistemi i planifikimit, të krijohet planifikimi afatmesëm për t'u lidhur me prioritetet dhe për të parandaluar vendimet ad hoc
- 2.3.23.Të fuqizohen mekanizmat e kontrollit, p.sh. kontrollet ad hoc në baza shembujsh dhe auditime pas nxjerrjes

Licensimi i shërbimeve dhe hapësirave lokale, përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitetet kulturore dhe të zbatitjes, ushqimin, akomodimin, tregjet, shitësat ambulantë (në rrugë), transportin publik lokal dhe taksi

- 2.3.24.Të zhvillohen procedura të brendshme/kritere të qarta të duhura që adresojnë risqet kryesore të integritetit lidhur me proceset e licensimit dhe që parandalojnë vendime subjektive
- 2.3.25.Të fuqizohen mekanizmat e kontrollit, p.sh. kontolle ad hoc në baza shembujsh dhe auditime

Shërbimet publike

- 2.3.26. Të zhvillohen dhe zbatohen aktet nënligjore dhe planet e punës të ndërlidhura me to për të qartësuar procedurat përxjerrjen e lejeve për shërbimet përkatëse dhe zbatimin e tyre të plotë dhe të kënaqshëm
- 2.3.27. Të minimizohen mundësítë për kontakte direkte mes palëve të interesuara dhe zyrtarëve komunalë dhe të zbatohet ndarja e detyrave (vendimi të hartohet nga zyrtari profesional, ndërsa pagesa dhe dërgimi i vendimit të bëhet nga zyrtari tjetër)
- 2.3.28. Të merren masa për përshkrimet teknike të projekteve dhe të hartohen në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme në përputhje me aktet e zbatueshme ligjore

dhe me standardet. *Të rritet profesionalizmi i stafit të përfshirë në hartimin e specifimeve teknike dhe të ofrohet monitorim i vazhdueshëm dhe kontrollë për cilësinë e përshkimeve teknike që janë hartuar.*

2.3.29. *Të shtohen kontrollet dhe inspektimi i zbatimit të vendimeve për të vlerësuar respektimin e rregulloreve*

2.3.30. *Të krijohen dhe të mbahet me kujdes një sistem i strukturuar i raportimit të rregullt periodik për ekzekutimin e detyrave dhe projekteve të mbështetura mbi planet e punës përkatëse.*

Ndarja e hapësirave për banim

2.3.31. *Të zhvillohet një politikë e strehimit si dhe procedura të ndërlidhura që si minimum adresojnë risqet kryesore të integritetit në ndarjen e strehimit, strehim që mund të ndahet në mënyrë jo të rregullt tek përfituesit, p.sh. përfituesit mund të lëvizin lart në listën e pritjes për përfitimet të parregullta*

2.3.32. *Të gjithë aplikantët për strehim duhet të shënohen në një regjistër në Zyrën Komunale, që duhet të jetë në dispozicion për inspektim nga aplikantët*

2.3.33. *Të fuqizohen kontrollet mbi procedurën e dorëzimit dhe pagesës së kërkesave nga kontraktorët: kontolle për të siguruar cilësinë e ndërtimeve. Arranzhimet për siguri fizike*

2.3.34. *Të maksimizohet mbrojtja ndaj shkeljeve të integritetit përmes fuqizimit të kontolleve të sigurisë, në bazë të rishikimit të hollësisht të arranzhimeve për siguri fizike; p.sh. fokusi specifik i vihet sigurisë së infrastrukturës, aseteve dhe stafit.*

2.4. Fuqizimi i mëtejshëm i kontolleve të integritetit në kontrollin dhe auditimin e brendshëm dhe në funksionet e inspektimit

Arsyetimi: Rritja e cilësisë së funksioneve të auditimit dhe inspektimit të brendshëm është identifikuar si prioritet për procesin e planifikimit të integritetit. Për të vepruar në mënyrë efektive si shtyllë e SMI brenda Komunës, sistemi që përdoret aktualisht perceptohet se ka nevojë për ndryshime rrënjesore. Kjo përfshin ndër të tjera një riorganizim të plotë; prurjen e një auditimi të bazuar tek vlerësimi dhe të një sistemi të planifikimit të inspektimit (p.sh. vlerësim i mjedisit të auditimit të brendshëm; vlerësimi i riskut të sistemit të auditimit faktorët e kritereve të riskut dhe metodat për vlerësimin e kritereve të riskut; renditjen sipas prioritetit të sistemit të auditimit; strategjinë e auditimit të brendshëm etj); caktimin e stafit të duhur dhe zhvillimin profesional të stafit të angazhuar; procedura rigorozë të monitorimit dhe kontolle specifike të integritetit.

- 2.4.1. *Të riorganizohet në mënyrë rrënjosore sistemi ekzistues i auditimit të brendshëm dhe inspektimeve për të rritur efektivitetin, llogaridhënien dhe transparencën dhe kështu të rrisë rezistencën ndaj korruptionit dhe shkeljeve të integritetit.*
- 2.4.2. *Të zhvillohen si duhet udhëzues operativë që të mbulojnë planifikimin, ushtrimin, monitorimin dhe përcjelljen e funksionit të auditimit dhe inspektimit. Të adresohen çështje si menaxhimi i riskut, veprime specifike për kontolle, planifikimi i auditimit të brendshëm/inspektimit, gjetja e burimeve për auditim të brendshëm/inspektim, vlerësimi i performancës së auditimit të brendshëm/inspektimit dhe sigurimi i cilësisë. Këto udhëzues t'i komunikohen të gjithë stafit.*
- 2.4.3. *Të përmirësohet sistemi i komunikimit (rrjedha e informacionit) mes njësisë së auditimit të brendshëm dhe organeve të tjera komunale. Për këtë qëllim, duhet të implementohet një sistem i cilësisë së informacionit në të gjitha proceset e punës.*
- 2.4.4. *Të sigurohet planifikim efektiv i auditimit që është sensibilizuar nga rezultatet e vlerësimit të riskut. Të monitorohet implementimi i planit të auditimit dhe të planifikohen masa përmirësuese në rast dështimi.*
- 2.4.5. *Të rritet përdorimi i auditimeve ad hoc në mënyrë rastësore për të përcjellë inspektimet e kohëve të fundit dhe për të vërtetuar gjetjet/procedurat e përdorura.*
- 2.4.6. *Të gjenden burimet e duhura për funksionin e kontrollit, inspektimit dhe auditimit përmes marrjes në konsideratë në mënyrë të kujdeshme të zbrazëtirave ekzistuese në kapacitete. Aty ku është e realizueshme, të ruhet rotacioni dhe parimi i 'katër syve' për të shmangur krijimin dhe forcimin e marrëdhënieve korruptive.*
- 2.4.7. *Të sigurohet zbatimi efikas i konfliktit të interesit në proceset e auditimit dhe inspektimit për t'u siguruar se stafi i përgjedhur për të kryer këto funksione është i çliruar nga dyshimet e ndërlidhura me integritetin. Për këtë qëllim, të përcaktohen kërkesa të qarta, dhe të kryhen kontolle rastësore për efikasitetin e implementimit të tyre.*
- 2.4.8. *Të zhvillohen më tej kompetencat profesionale të të gjithë pjesëtarëve të stafit të angazhuar në funksionet e kontrollit, inspektimit dhe auditimit. Për këtë qëllim, të krijohet dhe të*

- implementohet një program i specializuar për trajnimin e auditorëve dhe inspektorëve dhe/ose të konsiderohet mundësia e trajnimeve që ofrohen nga IKAP dhe ofrues të tjerë të specializuar për trajnime. Lëmitë: kryerja e auditimeve specifike (p.sh. - auditime për mashtrime, auditime të TI-së, auditime për menaxhimin e cilësisë), zbatimi i procedurave të auditimit (gjetja e mostrës, intervistat, mjaftueshmëria e provave etj.).
- 2.4.9. Të zhvillohet dhe të mirëmbahet një *Monitor-Ueb* si një sistem elektronik që monitoron përcjelljen e aktiviteteve të auditimit të brendshëm dhe inspektimit për t'u siguruar se të gjitha rastet e shkeljeve të dyshuara janë zgjidhur në mënyrë të kënaqshme. Sistemi merret me rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe regjistrон progressin që është

- arritur në implementimin e tyre dhe do të funksionojë si një platformë e vetme që menaxherët publikë të monitorojnë dhe të vlerësojnë veprimet për kontolle të brendshme.
- 2.4.10. Në baza periodike të vlerësohet *efektiviteti i sistemit të auditimit të brendshëm* dhe *të inspektimit* në bazë të procedurave të zhvilluara dhe indikatorëve relevantë. Të krijohet mundësia për publicitet të rezultateve që të forcohet fokusi tek parandalimi.
- 2.4.11. Të zhvillohet më tej *sistemi ekzistues i procesimit të brendshëm* dhe *të jashtëm* të *lavdërimeve/ankesave* si instrument që rrit llogaridhënien. Të merret parasysh shfrytëzimi i një regjistri për të shënuar të gjitha ankesat me qëllim që ato të përcillen; të caktohet një zyrtar i lartë që do të jetë përgjegjës për të monitoruar ankesat dhe zgjidhjen e tyre. Të bëhet e mundur që rezultatet të komunikohen me kohë tek ushtruesi i ankesës. Të bëhet e mundur kryerja e analizave periodike (dyvjetore dhe vjetore) të sinjaleve, sugjerimeve dhe ankesave lidhur me cilësinë e shërbimeve dhe respektimin e standardeve për shërbimet e ofruara.
- 2.4.12. *Të forcohet më tej sistemi i komunikimit* lidhur me rezultatet e *inspektimeve* për të parandaluar me efektivitet raste kur informacioni është i vështirë të gjendet, gjë që e bën të vështirë për departamentet e tjera të kryejnë funksionet e tyre.

2.5. Të fuqizohen kontrolllet e integritetit në sistemin e menaxhimit financiar dhe në regjistrimin dhe menaxhimin e aseteve

Arsyetimi: Menaxhimi financiar, regjistrimi dhe menaxhimi i aseteve janë shtylla të forta të një sistemi të shëndoshë për menaxhimin e integritetit që të parandalohet shpërdorimi i burimeve publike dhe abuzimi i pushtetit që u është besuar. Mangësitë, në sa u tha më lart, rezultojnë jo vetëm në keqpërdorim të burimeve, por çojnë edhe në implementim joefikas të caqeve dhe të synimeve të caktuara. Në bazë të vlerësimit të riskut që është bërë, risqet e ndërlidhura janë vlerësuar si madhore. Kjo kërkon masa të targetuara nga nxitja dhe përcjellje të vazdueshme të implementimit të tyre.

Mast:

- 2.5.1. Të vihet në përdorim dhe të mirëmbahet një *mekanizëm i përshtatshëm* për të përcjellë shpenzimet e buxhetit çdo muaj, që

- t mikat e implementimit të buxhetit.
- ë 25.2. Të rritet *mbikëqyrja e jashtme mbi implementimin e buxhetit* duke
o qeverisë kale dhe nga vëzhgues të OJQ-ve të pavarura që të
f monitorojnë *implementimin e buxhetit* rregullisht, pra, çdo
r tremujor. Kjo do të hapë proceset dhe do të sigurojë se procesi
o zhvillohet me efektivitet.
- j 25.3. Të parandalohet përvetësimi i fondeve. Të plotësohet,
ë mirëmbahet dhe azhurnohet rregullisht një *regjistër i aseteve*
m dhe ai të monitorohet çdo muaj.

n
d
ë
s
i
e
f
e
k
t
i
v
e
p
ë
r
t
ë
p
ë
r
c
j
e
l
l
ë
d
i
n
a

- 2.54. Të bëhen të mundur *auditime* të *rregullta* dhe ad hoc të *regjistrimit* të pronës. Të rritet kontrolli mbi regjistrimin e pronës duke krijuar mundësinë për kontolle ad hoc të njëjtë vend për të vërtetuar nëse regjistrimi është i plotë, preciz dhe i saktë.
- 2.55. Si masë mbrojtëse ndaj keqpërdorimit të automjeteve për përdorim personal, të vihen në përdorim *registrat e automjeteve, GPS* dhe *librat e shënimave* të cilët të monitorohen.
- 2.56. Të lidhen databazat e kadastrës dhe planifikimit urban me njërit-tjetrin, me qëllim që të lejojnë qasje në shënimet e kadastrës.
- 2.57. Të vihet në përdorim një procedurë e qartë për të bllokuar llogaritë e taksapaguesve jo të rregullt, që nuk i kanë paguar taksat e tyre, për të shmangur vendime subjektive dhe arbitrale. Të monitorohet implementimi i tyre duke përfshirë dhe kontolle rastësore ad hoc.
- 2.58. Të fuqizohet monitorimi dhe mekanizmat e kontrollit për zbatimin e udhëzimeve për caktimin e kushteve të shërbimeve komunale.
- 2.59. Të sigurohet *interpretim uniform* i dispozitave relevante për komunën nga *Ligji për tatimin mbi pronë* duke nxjerrë udhëzues për interpretim dhe duke ofruar trajnime të brendshme.
- 2.510. Të mundësohet qasja në informacionet e kadastrës për seksionin e *tatimit mbi pronë*

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 3:

Të rritet korniza e burimeve njerëzore për të udhëhequr dhe përkrahur reformat e integritetit, për të menaxhuar sistemin e integritetit dhe për të implementuar objektivat/masat e integritetit përmes përmirësimit të dukshëm të aspekteve të SMBNJ dhe funksionit të DBNJ

Linjat e aktivitetit dhe masat përkatëse

- 3.1. Fuqizimi i mëtejshëm i nivelit të lartë strategjik dhe funksionit mbikqyrës brenda Komunës së Vitisë përmes kodifikimit të rregullave të integritetit në funksionimin e Kuvendit Komunal**

Arsyetimi: Kuvendi Komunal është organi më i lartë i Komunës që i ushtron funksionet e tij në qeverisjen lokale ashtu si përcaktohen në LVQL dhe Statutin Komunal. Anëtarët e tij ushtrojnë kompetenca të rëndësishme, që përfshijnë edhe nivele të larta të riskut nga perspektiva e integritetit: p.sh. të tillë që kanë të bëjnë me miratimin e buxhetit dhe planet e investimit; nivelin e taksave, tarifave dhe pagesave komunale; vendime që kanë të bëjnë me pronën komunale; miratime dhe ndryshime të: Planit Komunal për Zhvillim (PKZH); Planit për Zhvillim Urban (PZHU) dhe Planit Rregullativ Urban (PRRU). Kuvendi zgjidhet direkt në përputhje me dispozitat e Ligjit për Zgjedhje Lokale. Për shkak të kësaj llogaridhënieje vertikale, instrumentat tradicionale horizontale për parandalim të integritetit kanë zbatueshmëri të kufizuar. Mirëpo kjo nuk e përjashton Kuvendin Komunal nga platforma e përgjithshme e parandalimit të integritetit, pasi ajo ka rol të veçantë si shtyllë e integritetit në funksionimin e komunës.

- 3.1.1. Të konsiderohet vlera e shtuar e zhvillimit të një *Kodi të Etikës/Kodi të Sjelljes/Rregullave të Integritetit* për të adresuar *Anëtarët e Kuvendit Komunal*. Në përputhje me standarde të disponueshme në këtë lëmi, kjo gjë do të dërgonte një mesazh të qartë dhe pozitiv tek komuniteti lokal sa i përket zotimit për integritetit nga këshilltarët komunalë.
- 3.1.2. Të merret parasysh përfshirja e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Ditët e Anti- Korruptionit, Forumet e Hapura dhe aktivitete të tjera publike që kanë të bëjnë me transparencën dhe anti-korruptionin.

3.2. Rritja e zbatueshmërisë së Kodit të Sjelljes për të gjithë stafin

Arsyetimi: Standardet e sjelljes konsiderohen si thelbësore për të udhëhequr sjelljen e zyrtarëve publikë në përputhje me qëllimin publik të organizatës ku ata punojnë. Zbatimi i tyre efektiv kërkon mbështetje të kapacitetit për zhvillim dhe vetëdijësim, si dhe një sistem të strukturuar të monitorimit.

- 3.2.1. Të sigurohet *niveli i duhur i njohurisë që ka i gjithë stafit për Kodin e Sjelljes* (p.sh. trajnime fillestare dhe të vazhdueshme). Familjarizimi i punonjësve të rinj me Kodin e Sjelljes (p.sh. nënshkrimi i deklaratës se kanë lexuar dhe e kanë kuptuar kodin ashtu siç është paraqitur; me rregulla që kanë të bëjnë me punën jashtë orarit dhe udhëtimet; procedurat e zbatueshme për përdorimin e aseteve komunale)
- 3.2.2. Sipas nevojës, kodi i sjelljes të zbatohet edhe nga *ofruesit e shërbimeve* (p.sh. përfshirja e dispozitiveve relevante të kodit në kontrata)
- 3.2.3. Të vihet në përdorim *këshillimi për etikë ose Komisioni i Integrititetit* brenda Komunës për të arritur të kuptuar koherent të Kodit të Sjelljes dhe të rregullave të integrititetit dhe për të ndihmuar në zgjidhjen e dilemave etike
- 3.1.1. Të vihen në dispozicion të publikut *rezultatet e hetimit* të shkeljeve të Kodit të Sjelljes brenda Komunës duke bërë të ditura trendet dhe shtytësit.

3.3. Fuqizimi i mëtejshëm i rezistencës ndaj shkeljeve të integrititetit gjatë ekzekutimit të funksionit të SMBNJ dhe DBNJ në Komunën e Vitisë

Arsyetimi: Pavarësisht të gjitha masave të tjera, është parametri njerëzor ai që përcakton profilin final të sistemit të menaxhimit të integrititetit të organizatës. Njerëzit janë aseti më i madh që ka Komuna dhe ata janë në derën e parë dhe në atë të pasme të gjitha proceseve. Pak masa mund të krahasohen me efektin final të këtyre që përkujdesen si duhet për menaxhimin dhe zhvillimin e stafit.

- 3.3.1. Të përmirësohen më tej proceset e *rekrutimit dhe të përzgjedhjes* përmes fuqizimit të rregullave të brendshme për rekrutim, të përkufizimit të standardeve minimale të transparencës; monitorimit strikt të shpalljeve për vende të lira, përfshirë implementimin e kërkesave për transparencë, regjistrimin e aplikimeve dhe letrave të pranimit; rregulla të qarta për funksionimin e komisioneve përzgjedhëse (deklaratat e nënshkruara të Kl nga të gjithë anëtarët, intervista me kandidatët e mundshëm mbahen nga menaxherët e parë dhe BNJ, secili anëtar merr shënimë, dorëzohen në BNJ dhe arkivohen në dosjen e aplikantit); auditim ad hoc i aktiviteteve të komisioneve të

rekrutimit, ku sigurhet përcjellja e auditimit dhe regjistrimi i aplikacioneve dhe letrave të pranimit nga mekanizmat efektivë për ankesa. Të mbahen shënimet nga intervistat e bëra nga secili anëtar i komisionit përzgjedhës për dosjen e rekrutimit.

- 3.3.2. *Të vërtetohen kualifikimet* e aplikantëve për vende pune si pjesë e kërkesës së tyre për ndonjë pozitë para se ata të caktohen. Të informohen të gjithë aplikantët me fjali të qarta dhe pretendimet e rrejshme për kualifikime të rezultojnë në largimin e tyre dhe/ose ndjekjen penale për veprën përkatëse. Të sigurohet se të gjithë aplikantët nënshkruajnë çertifikatën ku deklarojnë se kualifikimet të cilat ata i pohojnë janë të vërteta dhe se ata e pranojnë që secili kualifikim i deklaruar rrejshëm mund të rezultojë në largimin e tyre. Të përfshihet një dispozitë që i lejon

- Komunës të ndërpresë marrëdhënien e punës së ndonjë aplikanti që deklaron rrejshëm kualifikimet.
- 3.3.3 Përzgjedhja dhe rekrutimi i personelit të përfshihet si risk për t'u vlerësuar në *planin e auditimit të brendshëm*. Të bëhen *kontolle ad hoc* të procedurave të rekrutimit të përzgjedhura në mënyrë rastësore.
- 3.3.4 Të sigurohen *përshkrimet e vendeve të punës* të qarta dhe tërësore që përcaktojnë përgjegjësitë individuale në përputhje me rregulloret relevante për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës; të sigurohet se stafi është i njohur me to. Punonjësit, përshkrimet e vendeve të punës të të cilëve përfshijnë ndonjë formë të vendimmarrjes kritike apo ndonjë formë të autorizimit për shpenzime, duhet të detyrohen të plotësojnë deklaratën e KI (që rishikohet vit pas viti dhe azhurnohet e monitorohet nga BNJ).
- 3.3.5 Sipas rregulloreve relevante, të implementohet një politikë e brendshme lidhur me *pranimin e punësimit nga jashtë* ndërkohe që punojnë për komunën.
- 3.3.6 Të forcohet edhe më shumë *vlerësimi i personelit* dhe të merren masa për politika të promovimit në bazë të meritave: të zhvillohen *tregues* të qartë dhe gjithëpërfshirës për të vlerësuar cilësinë e punës, të merren masa për dokumentacion të qartë të auditimit të vlerësimit; rezultatet të komunikohen me kohë dhe të krijohen mundësi të vërteta për ankesa.
- 3.3.7 Vazhdimisht të përmirësohet *sistemi i shpërblimit* si pjesë e BNJ në përputhje me kriteret objektive. Të themelohet një *sistem i cilësisë* së *shpërblimit* dhe *motivimit të stafit, si dhe të indikatorëve të performancës*. Të mbahet niveli i duhur i transparencës së funksionimit të sistemit.
- 3.3.8 Të zhvillohet një politikë dhe të implementohet një *sistem për matjen periodike të kënaqshmërisë* së *stafit* duke zhvilluar anketime si "sistem i paralajmërimit të hershëm" për të zbuluar probleme dhe trende.
- 3.3.9 Të zhvillohet një sistem i besueshëm i *Analizës së Nevojave për Trajnim (ANT)* për të përcaktuar nevojat aktuale për trajnim dhe për të garantuar efektivitetin e procesit të trajnimit. Të kryhen kontrollle të rregullta rastësore për të siguruar se pjesëmarrja në mundësitetë e trajnimit është vendosur në bazë të nevojave dhe meritave dhe jo në baza arbitrale/subjektive.
- 3.3.10 Të vazhdojë *përmirësimi i formatit të trajnimit*: praktikë e fokusuar tek trajnimi profesional që kërkon, sidomos për profesione të specializuara, shkëmbimi i përvojave praktike. Të merren masa që kërkesat të sillen me sukses tek ofruesit e trajnimit dhe se ata i

- përshtasin trajnimet sipas këtyre nevojave. Të shfrytëzohen komentet e të trajnuarve për të përmirësuar mungesën e efikasitetit.
- 33.11. Të krijohet një *sistem i besueshëm për vlerësimin e trajnimit* që mbulon jo vetëm matjen e perceptimeve/reagimeve ndaj trajnimit, por edhe bartjen në vendin e punës dhe ndikimin në organizatë. Rezultatet t'i komunikohen menaxhmentit të lartë.

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 4:

Mundësimi i mjedisit të jashtëm për të promovuar modernizimin dhe për të mbështetur zotimin kolektiv për integritet përmes përmirësimit të koordinimit me palët e interesit në sektorët publikë, privatë dhe OJQ, aktiviteteve për vetëdijësim dhe komunikim, rritjes së transparencës dhe angazhimit të qytetarëve dhe shpërndarjes së praktikave të mira.

Linjat e aktivitetit dhe masat përkatëse

4.1. Fuqizimi i mekanizmit të konsultimit dhe komunikimit formal dhe joformal me palët e jashtme kryesore të interesit; promovimi i angazhimit të qytetarëve si bazë për pjesëmarrje dhe mbikëqyrje sociale; përfshirja e medias, OJQ-ve dhe grupeve të biznesit si partnerë socialë në axhendën e integritetit

Arsyetimi: Bashkëpunimi mes administratave komunale dhe OJQ-ve, operatorëve nga sektori privat dhe medias është një faktor i rëndësishëm për suksesin e reformës dhe modernizimin e axhendës. Ndryshimi në orientimin e komunës nga qëllimi parësor tek roli i saj si zbatuese dhe grumbulluese e të hyrave tek roli i ofrueses së shërbimeve, ku përfshihet ofrimi efektiv i shërbimeve me përgjegjësi mobilizuese për të hyrat, kërkon përkrahje të fortë nga komuniteti lokal. Kjo përkrahje mund të mbështetet nga një program i menduar mirë për sensibilizim të të gjithë grupeve të targetuara, përfshirë edhe takime konsultative periodike të nivelit të lartë.

- 4.1.1. Të rritet *transparenca* dhe të merren masa për *konsultime me palët e jashtme të interesit gjatë zhvillimit të rregulloreve komunale dhe të buxhetit*. Përdorimi proaktiv i kanaleve të shumëlojshme për të inkurajuar pjesëmarrje kuptimplotë të publikut dhe për të ftuar njerëzit të komentojnë (p.sh. postimi i projekt-rregulloreve në uebfaqe, iniciimi i diskutimeve publike, forume në ueb, fokus grupe etj.)
- 4.1.2. Të merren masa që të ndërmerren konsultime me palët e interesit dhe që paraqitjet nga publiku të shqyrtohen mirë para nxjerrjes së planeve kryesore strategjike dhe dokumentave për politika të Komunës
- 4.1.3. Të demonstrohet fokusi tek integriteti në *strategjinë e*

komunikimit të jashtëm. Ajo jo vetëm që ofron informata për klientët, por edhe promovon arritjet e Komunës për sa kanë të bëjnë me reformat për integritet. Të forcohet/fokusohet mesazhi i trupave anti-korrupsion për palët e jashtme të interesit.

- 4.1.4. Të zhvillohen *partneritete me shoqërinë civile* në fushën e anti-korrupsionit. Të zhvillohet një Program i Sensibilizimit për Integritet mes Komunës dhe OSHC të njoitura si aktive në fushën e anti-korrupsionit. Të shqyrtohet mundësia e zhvillimit të këshillave për transparencë lokale (organizata gjysëm formale, që pranohen nga administrata publike lokale), që ribashkojnë në nivel lokal administratën publike lokale me OSHC dhe që kanë gjeneruar rritje në transparencën e administratës lokale, nga përfshirja e shoqërisë civile në proceset e vendimarrjes si dhe në monitorimin aktiv të procesit të prokurimit publik dhe të përdorimit të buxhetit.
- 4.1.5. Të themelohen *grupe pune* teknike për menaxhimin e riskut në fushat e ndjeshme dhe të brishta ndaj korrupsionit dhe të sigurohet përfshirja e shoqërisë civile si "roje e qytetarëve" përmes funksionimit të tyre
- 4.1.6. Të forcohen mekanizmat e konsultimeve me bizneset përmes një *programi sensibilizimi* të targetuar për sektorin privat, përfshirë këtu takime periodike konsultative të nivelit të lartë në zona specifike
- 4.1.7. Të mundësohet forcimi i medias në nivel lokal – sidomos radios – si një mjet për të edukuar qytetarët rrëth të drejtave të tyre, por edhe si një mjet për gazetari hulumtuese për çështje të korrupsionit. Të shqyrtohet mundësia për të hyrë në partneritet me shoqata lokale relevante gazetare për ngritjen e vetëdijësimit për integritetin. Të rritet rrjedha e informacionit drejt medias dhe publikut lidhur me parandalimin e korrupsionit dhe të aktiviteteve të luftës kundër tij;
- 4.1.8. Të rritet bashkëpunimi institucional në anti-korrupsion përmes kontakteve me komuna të tjera. Të shqyrtohet krijimi i një *rrjeti të integritetit* në sektorin e qeverisë lokale për të mbështetur ndarjen e informacionit dhe të përvojave dhe për të ndërtuar një zotim të përbashkët
- 4.1.9. Të promovohet zhvillimi i programeve bazike të edukimit qytetar nëpër shkolla për të rritur përgjegjësinë e qytetarëve.

4.2. Promovimi i transparencës si thelbësore për rritjen e llogaridhënieς dhe mbikëqyrjes së jashtme të Komunës


Arsyetimi: Transparenca dhe angazhimi i palëve të interesit mund të lehtësojnë: rezultate më të mira të politikave me kosto më të ulët; respektim më të lartë të vendimeve të arritura, përgjegjësi të ndara për ofrim të shërbimeve, si dhe bashkë-pronësi në rritjen e integritetit. Transparenca e plotë e rregulloreve, vendimeve dhe rezultateve të implementimit, treguesve të performancës dhe statistikave do të jenë më të rëndësishmet për të bindur në nivel lokal për rëndësinë e përpjekjeve anti-korrupsion të komunës.


- 4.2.1. Në pajtim me rregulloret relevante, të merren masa që qytetarët dhe bizneset të kenë *informacion të mjaftueshëm* të saktë, konsistent, me qasje dhe të lehtë për t'u përdorur që u mundëson të përmbushin detyrimet e tyre. Për këtë

- qëllim, të implementohet një qasje proaktive për të informuar qytetarët përmes përdorimit të kanaleve të ndryshme: p.sh. fletushka, mësime/ndihma në uebfaqe, etj. të mirëmbahen dhe të azhurnohen rregullisht dokumentat publikë që përshkruajnë standartet e pritshme të performancës; të merren masa që rregulloret relevante të postohen në format të lehta për t'u përdorur dhe janë të lehta për t'u përdorur.
- 4.2.2. Të merret parasysh vlera e shtuar e prezantimit të *Portalit të transparencës* për të integruar informacione mbi: rregulloret relevante; Kodin e Sjelljes; Statutin e Shërbimeve për Qytetarë; raportet vjetore për menaxhim; ekzekutimin e buxhetit; raportet e jashtme të auditimit; prokurimin; rekrutimin dhe vendet e lira; kontratat administrative; udhëtimin dhe mëditjet; linjën e telefonit anti-korrupsion.
 - 4.2.3. T'u ofrohet qytetarëve *informacion në kohën e duhur përmes uebfaqes për aktivitetet dhe vendimet që merren nga kuvendi komunal dhe organet e tij administrative* si dhe për buxhetet dhe rezultatet e programit. Të publikohen 'raporte të lehta për t'u kupuar për buxhetin' që ofrojnë përbledhje të thjeshta të operacioneve financiare, përfshirë kontrata të prokurimit publik dhe deklarata të aseteve të zyrtarëve komunalë.
 - 4.2.4. Të monitorohet implementimi i mekanizmave të krijuar për paraqitjen e kërkesave nga qytetarët dhe ankesat e tyre (p.sh. linja telefonike anti- korrupsion); të merren masa që të dhënat dhe trendet analizohen dhe komunikohen tek menaxhmenti i lartë. Të merren masa që qytetarët të janë të informuar për masat vijuese që janë marrë.
 - 4.2.5. Nëse është e nevojshme, të ofrohen trajnime në shkathtësi të TI-së që janë të nevojshme për të ruajtur përdorimin dhe transparencën e uebfaqes.
 - 4.2.6. Të sigurohet monitorim i duhur dhe profesional i implementimit të *Ligjit për Qasje të Lirë në Informacion* nga ana e komunës.

Viti, Mars 2021

Kryetari i Komunës





Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit mbi Vetqeverisjën Lokale Nr.03L-040(Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008 lidhur me nenin 50 shkrona l të statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491 të dates 21.04.2011, lidhur me Udhëzimin Administrativ Nr.06/2009 për dhënjen në Menaxhim të Vendgjetive të Përbashkta ,Kryetari i Komunës së Vitisë propozon këtë;

Propozim Vendim

Për Formimin e Komisionit për procedurat mëtutjeshme të dhënjes me qira vendgjetisë në teritorin e Komunës së Vitisë

Neni I

Me qëllim të rritjës , kultivimit, mbrojtjës, shfrytëzimit të kafshve të egra dhe menaxhimit të mire të tyre,Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit formimin e Komisionit për procedurat të mëtutjeshme të dhënjes me qira të vendgjetisë.

Neni II

Bazuar në nenin 3 parografi 3 të Udhëzimit administrativ Nr.06/2009 për dhënje dhe Menaxhim të Vendxhuetive të Përbashkta,Procedurat për dhënjen me qira të vendgjetisë bëhen përmes procedures së ofertës publike e cila shpallet pas themelimit të vendgjetisë.

Neni III

Të drejat dhe detyrat e komisionit caktohen në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2009, sipas planeve menaxhuese 10 vjeqare të cilat duhet të hartohen brenda 6 muajsh nga dita e lidhjës së kontratës dhe ti plotësojnë të gjitha kushtet dhe obligimet që dalin nga neni 39 i Ligjit të Gjetisë.

Neni IV

Komisioni ka këtë përbërje:

- 1.Granit Abdyli-antarë
- 2.Sebahate Haziri-kryetar

3.----- - antarë

4.----- - antarë

5.----- - antarë

Neni V



Menaxhimi i vendgjetisë bëhet me dhënjen e tyre në menaxhim në formë të qirasë në afat prej 10 viteve

Neni VI.

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Më dt.16.04.2021

Propozues,Kryetari i Komunës së Vitisë

Sokol Haliti




REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA	21-04-2021
Vlera Price	Vadimost Value	
02-035/02 229		



Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi vetëqeverisjn lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.28, qershori 2008) dhe neni 6 paragrafi 1, pika 1.1, neni 8 paragrafi 1 pika 1.1 lidhur me neni 14, të Ligjit me nr. 06/L-092, Për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare Nr.10, prill 2019), neni 6 pika 3, neni 8 i Rregullorës nr. 09/2020 për caktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzimin dhe kembimin të pronës së palujtshme të komunës dhe neni 50 paragrafi 1 shkronja 1), të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi me datën 19.04.2021, bën këtë :

P R O P O Z I M V E N D I M
PARAPRAK PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE PËRMES ANKANDIT
PUBLIK (PARKINGJET PUBLIKE)

Neni 1.

Me këtë propozim – vendim paraprak, propozohet dhënya në shfrytëzim e pronës së palujtshme të Komunës së Vitisë, në shfrytëzim afatshkurtër pësonave fizik dhe juridik si në vijim:

1. Njësia kadastrale me nr. P-70101007-02592-3, me sipërfaqe prej 102 m²,
2. Njësia kadastrale me nr. P-70101007-02592-4, me sipërfaqe prej 53 m²,
3. Njësia kadastrale me nr. P-70101007-02592-5, me sipërfaqe prej 96 m²,
4. Njësia kadastrale me nr. P-70101007-02592-6, me sipërfaqe prej 104 m²,
5. Njësia kadastrale me nr. P-70101007-02592-7, me sipërfaqe prej 156 m² dhe
6. Njësia kadastrale me nr. P-70101007-02592-8, me sipërfaqe prej 118 m², (të cilat gjinden në rrugën „Adem Jashari“, në qytetin e Vitisë) zona kadastrale në Viti, komuna e Vitisë.

Neni 2.

Afat kohorë për dhënjen në shfrytëzim të pronës së palujtshme komunale është afat shkurtër me kohëzgjatje prej 3 viteve me destinin Parkingjet publike me qellim të shfrytëzimit nga ana e pësonave fizik apo juridik.

Neni 3.

Qellimi i dhenjës në shfrytëzim të pronës komunale është Interesi Publik dhe përfitimi ekonomik i komunës nga prona komunale .

Neni 4.

Procedurat për dhënjen e pronës së palujtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes ankandit publik, në harmoni me Ligjin Nr.06/L092, Për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës.

Neni 5.

Menyrat dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së palujtshëme do të përcaktohen me kontratë e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfitusiti marrjes në shfrytëzim të pronës së palujtshme në periudhë afatshkurtër të shfrytëzimit me të drejt të shkeputjesë së kontratës edhe para afatit nese prona e dhënë në shfrytëzim nuk shfrytëzohet për qëllime të cekura në nenin 2 të këtij vendimi.

Neni 6.

Për zbatimin e këtij propozim – vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoria e Administratës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjent dhe Drejtoria e Financave të komunës së Vitisë.


Neni 7.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Drejtori:
Majlinda Ostroglava



Kryetari i Komunës:
Sokol Haliti





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY
KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VITI
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Viti



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1297

640121

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 20.04.2021

Koha/ Vreme/ Time: 09:13:02

Nënshtkrimi/Potpis/Siguri

Shönim/Beloška/Neto



Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshtkrimi/Potpis/Signature:



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VITI
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Viti

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70101007-02592-3	Parcelë / Parcela / Parcel	102
P-70101007-02592-4	Parcelë / Parcela / Parcel	53
P-70101007-02592-5	Parcelë / Parcela / Parcel	96
P-70101007-02592-6	Parcelë / Parcela / Parcel	104
P-70101007-02592-7	Parcelë / Parcela / Parcel	156
P-70101007-02592-8	Parcelë / Parcela / Parcel	118

640/21

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 20.04.2021

Koha/ Vreme/ Time: 09:13:03

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:



Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure /

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA / IZVOD IZ CERTIFIKATA / EXTRACT OF CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : KOMUNA E VITISË---RRUGET

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:		640/2021
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:		20.04.2021 - 09:06
Komuna / Opština / Municipality:		VITI / VITINA / VITI

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

VITI / VITINA / VITI

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACIO OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemni/Emri i afarizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznesit) Last Name / Business Name	Emri First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/biznesit Licitni broj/broj postlovanja ID-No.	Shiteti i shtetësisë apo regjistrimit Država državljanstva ili uknjizenja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishmen	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
KOMUNA E VITISË---RRUGET		/	/	KCID0102133	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO			16.05.2014

A.I ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postal Pošanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address Details	Adresa tjeter Druga adresa Other address	Azhuruar Azurirano Updated
VITI / VITI			VITI	16.05.2014

B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

Njësie kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type	Kati/ Kattet Br.Sprat a/ Spratova Floor number	Vendi i qajtjur Zvano mesto Place name	Spërfaqja Površina Area	Shfrytëzimi aktual/Kultura- upotreblia/ Kultura-klasa use/Culture-class	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azuruar Ažurirano Updated
P-70101007-02592-3	VITI / VITINA / VITI	Viti / Vitina / Viti	PARCELLË / PARCELA / parcel	Prone shqetërore Drushtvena Inovina Socially owned Land /U	SELO MAR.TITA ULICA / SELO MAR.TITA ULICA / SELO MAR.TITA ULICA	102	Rrugë E Pakategor - / / Infrastruktura - Nekategorisani Put - / / Infrastructure - UncategorizedRoa d - / /	1 / 1	Posedim individual / Individuala Drzavina / Single possessor	04.01.2019	
P-70101007-02592-4	VITI / VITINA / VITI	Viti / Vitina / Viti	PARCELË / PARCELA / parcel	Prone shqetërore Drushtvena Inovina Socially owned Land /U	SELO MAR.TITA ULICA / SELO MAR.TITA ULICA / SELO MAR.TITA ULICA	53	Rrugë E Pakategor - / / Infrastruktura - Nekategorisani Put - / / Infrastructure - UncategorizedRoa d - / /	1 / 1	Posedim individual / Individuala Drzavina / Single possessor	04.01.2019	
P-70101007-02592-5	VITI / VITINA / VITI	Viti / Vitina / Viti	PARCELE / PARCELA / parcel	Prone shqetërore Drushtvena Inovina Socially owned Land /R	SELO MAR.TITA ULICA / SELO MAR.TITA ULICA / SELO MAR.TITA ULICA	96	Infrastruktura - Rrugë E Pakategor - / / Infrastruktura - Nekategorisani Put - / / Infrastructure - UncategorizedRoa d - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	04.01.2019	
P-70101007-02592-6	VITI / VITINA / VITI	Viti / Vitina / Viti	PARCELE / PARCELA / parcel	Prone shqetërore Drushtvena Inovina Socially owned Land /R	SELO MAR.TITA ULICA / SELO MAR.TITA ULICA / SELO MAR.TITA ULICA	104	Infrastruktura - Rrugë E Pakategor - / / Infrastruktura - Nekategorisani Put - / / Infrastructure - UncategorizedRoa d - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	04.01.2019	

P-70101007-02592-7	VITI / VITINA / VITI	Viti / Vitina / Viti	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Drushtvena Imovina Socially owned Land /R	SELO MAR.TITA ULICA / SELO MAR.TITA ULICA / SELO MAR.TITA ULICA	156	Infrastruktura - Rrugë E Pakategor - // Infrastruktura - Nekategorisani Put - // Infrastructure - UncategorizedRoa d - //	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	04.01.2019
P-70101007-02592-8	VITI / VITINA / VITI	Viti / Vitina / Viti	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Drushtvena Imovina Socially owned Land /R	SELO MAR.TITA ULICA / SELO MAR.TITA ULICA / SELO MAR.TITA ULICA	118	Infrastruktura - Rrugë E Pakategor - // Infrastruktura - Nekategorisani Put - // Infrastructure - UncategorizedRoa d - //	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	04.01.2019

21-26
Mars
2021

Manifestimi Tradiconal Kulturo-Sportiv “Flakdani i Karadakut – 2021”

INFORMATË

13.04.2021

12.016/01-200

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT | Drejtori: Milot Lala



Republika e Kosovës
Republic of Kosova
Komuna e Vitisë
Municipality of Viti/Vitina
DrejtoriapërKulturë, Rinidhe Sport
Departament of Culture, Youth and Sports

DATË/A:	Prill, 2021
PËR/ZA/TO:	Komiteti për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal, Viti
NGA/ZA/FROM:	Z. Milot LALA Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport
PËRMES/OD/FROM:	Zt. Naim PIRA Kryesuesi Kuvendit Komunal
C.C	Zt. Sokol HALITI Kryetari Komunës së Vitisë
LËNDA:	Informatë për Manifestimin "Flakadani i Karadakut" edicioni i XIX-të

Përbajtja

I. KËSHILLI ORGANIZATIV I MANIFESTIMIT

- a) Përberja e Këshillit Organizativ
- b) Ndarja e detyrave të Trupës Koordinuese

II. RAPORTI NARRATIV I AKTIVITETEVE

- a) Aktivite Kulturore dhe sportive

III. RAPORTI FINANCIAR I MANIFESTIMIT

- a) Tabela e kostos totale buxhetore
- b) Tabela krahasuese (2020-2021) e shpenzimeve


IV. MBËSHTETËSIT E MANIFESTIMIT DHE MEDIAT

I. KËSHILLI ORGANIZATIV I MANIFESTIMIT

a) Përbërja e Këshillit Organizativ

- 1. Sokol Haliti - Kryetar i Komunës - Kryetar i Këshillit Organizativ**
- 2. Hasan Aliu - anëtar**
- 3. Naim Pira - anëtar**
- 4. Vjollca Kadolli - anëtare**
- 4. Milot Lala - anëtar**
- 5. Qemajl Rexhepi - anëtar**
- 6. Avdyl Bajrami - anëtar**
- 7. Ismet Sejdiu - anëtar**
- 8. Emrush Azemi - anëtar**

b) Ndarja e detyrave të Trupës koordinuese:



II. RAPORTI NARRATIV I AKTIVITETEVE

a) Aktivitet kulturore dhe sportive

Manifestimi Tradicional Kulturor e Sportiv “Flakadani i Kardakut 2021”, organizimi dhe mbajtja e edicionit 19-të me radhë (në rrethana të pandemisë COVID-19), si një nga ngjarjet më të mëdha kulturore në Komunën e Vitisë, ku tubon artistët dhe grupet artistike e të mbarë Kombit Shqiptar e me gjere.

Ky eveniment kulturore e sporti, u mbajt në saje mbështetjes së projektit “Flakadani i Karadakut 2021”, nga ana e Kryetarit të Komunës së Vitisë Z. Sokol Haliti, punës së palodhshme të Trupës Koordinuese dhe sipas masave kundër COVID-19, të rekomanduara nga IKSHP-ja.

Manifestimi Tradicional Kulturor e Sportiv “Flakadani i Karadakut 2021”, ka filluar më 21 mars 2021, ku u bë hapja solemne e manifestimit me dhezjen e Flakadanit dhe ka përfunduar më 26 mars me mbrëmjen finale të Festivalit Virtual Mbarëkombëtar të Ansambleve dhe Shoqërive Kulturore dhe Artistike. Në këtë tubim pos udhëheqjes komunale dhe shoqatave të ndryshme prezantuan edhe mysafir nga Lugina Preshevës si dhe me programet e tyre virtuale u paraqitën ansamblet kulturore nga mbarë trevat shqiptare dhe më gjerë.

Aktivitetet Kulturore dhe sportive:

- Garat regionale të recituesve – ketë vit, nuk i kemi mbajtur për shkak të Pandemisë KOVID-19
- Hapja e Ekspozitës me eksponate të dëshmorit Nijazi Azemi – Komandant Mjekrës, në 20 vjetorin e rënies heroike në altarin e lirisë, nga data: 21-26 Mars 2021.
- Ora e Madhe Letrare – ishte planifikuar të mbahet në Sallën e Kuvendit, por u mbajt sipas masave të rekomanduara nga IKSHP-ja, në Sallën e koncerteve të Shtëpisë së kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani” në Viti, më 23 mars 2021, me fillim në ora 16.00. Në Orën e Madhe Letrare prezantuan shkrimitarë, poetë nga të gjitha trevat shqiptare. Juria profesionale në përbërje 3 anëtarëve me kryetar Nazmi Beqiri, ka vlerësuar krijimet dhe poezitë më të mira të shkrimitarëve konkurrues të Orës së Madhe Letrare- “Flakadani i Karadakut 2021”.

Me çmimin e parë u nderua Ana Kove nga Shqipëria, çmimi i dytë i takoi Flora Brovinës nga Prishtina kurse çmimi i tretë u nda për poetin Adem Abdullahu nga Tetova.

Nga ana e organizatorit, Çmimi për Vepër Jetësore iu nda Prof. Dr. Nehas Sopaj

- Festivali Virtual Gjithëkombëtar i Shoqërive Kulturore e Artistike – u mbajt më 24, 25 dhe 26 Mars – programet e tyre virtuale i paraqiten 18 -të Shoqëri Kulturore artistike nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i zi, Presheva dhe Bursa e Turqisë, kurse my safire e mbrëmjes finale të festivalit Mbarëkombëtar të ansambleve dhe Shoqërive Kulturore dhe Artistike “Flakdani i Kardakut 2021”, ishte Solistja e mirënjojdhur nga estrada Shqiptare Merita Sahiti.

Mbrëmja e parë e festivalit, më 24 Mars:

<i>Nr.</i>	<i>Ansamlli, Grupi artistik, Shoqëria Kulturore</i>	<i>Vendi</i>	<i>Vlerësimi i Jurisë</i>
1.	AKV “KEMAJL AZIZI”	VITI	Jashtë konkurrencës
2.	SHKA “PRESHEVA JEHON”	PRESHEVË	
3.	SHKA “TINGUJT E VENDLINDJES”	STAGOVE-KAÇANIK	
4	SHKA “KOMORANI”	KOMORAN	
5.	AKV “NAKEM”	BURSA-TURQI	
6.	AKV “SKAMPA”	ELBASAN	

Mbrëmja e dytë e festivalit, më 25 Mars:

Nr.	<i>Ansambli, Grupi artistik, Shoqëria kulturore</i>	Vendi	<i>Vlerësimi i Jurisë</i>
1.	QENDRA KULTURORE “ANAMORAVA”	VITI	
2.	SHKA “MALËSORI”	GJONAJ – PRIZREN	
3.	SHKA “GJILANI”	GJILAN	
4.	SHKA “JAHI HASANI”	ÇEGRAN – GOSTIVAR	
5.	AKV “HASAN PRISHTINA”	VUSHTRRI	
6.	AKV “KASTRIOTËT	FERIZAJ	

Mbrëmja e tretë e festivalit, më 26 Mars:

Nr.	Ansambl, Grupi artistik, Shoqëria kulturore	Vendi	Vlerësimi i Jurisë
1.	AKVB "JONUZ RAMADANI"	SMIRE-VITI	
2.	SHKA "MAJA E KARAJFILIT"	PLAVE-GUCI/MALI I ZI	
3.	SHKA "SHOTË GALICA"	DRENAS	
4.	AKV "EMIN DURAKU "	SHKUP	
5.	AKVB "BAJRAM SHABANI"	KUMANOVE	
6.	AKV "SKENDERBEU"	KORÇË	

Juria profesionalë në përbërje: Sami Piraj muzikolog, Dilaver Kryeziu koreograf dhe Mustafë Lamallari prof. i muzikës, vlerësuan dhe ndanë 3 vendet e para dhe çmimin special të Festivalit Gjithëkombëtar të Shoqërive dhe Ansambleve Kulturore Flakdani i Karadakut 2021"

Vendin e parë iu nda AKV "Hasan Prishtina" nga Vushtrria, vendi i dytë AKV "Bajram Shabani" nga Kumanova dhe vendi i tretë i takoi SHKA "Malësori" – Gjonaj nga Prizreni. Ndërsa me çmimin special u nderua Qendra Kulturore "Ana Morava" nga Vitia, Kostumografia më autoktone AKV "Skënderbeu"- Korçë dhe Koreografja më e mirë, i takoi AKV "Emin Duraku" nga Shkupi.

- Më 26 Mars, me fillim nga ora 10.00, u bënë homazhe dhe vendosja e kurorave me lule te varrezat e dëshmorëve – Dëshmorit Nijazi Azemi – Komandant Mjekrra.

b) Aktivitetet sportive:

- Turniri revyal në futboll të vogël
- Garat sportive në Shah
- Garat sportive të pingpongut

Ku të gjitha ndeshjet u zhvilluan ditën e hapjes së manifestimit kulturor dhe sportiv "Flakadani i Kardakut-2021.

III. RAPORTI FINANCIAR I MANIFESTIMIT

a) Tabela e kostos buxhetore:

Fondi burimor	Lloji i shpenzimit	Kostoja në €
Komuna e Vitisë/DKRS	Akomodimi	30.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Zërim	820.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Dreka (Shujta për grupet artistike dhe sportive)	3,276.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Shtypja e mateiraleve grafike katalogje, banera citillajda, rollop, postera,shtypja në bez e flamujve bexha, gravura, maska etj.	3,305.00 €
Komuna e Vitisë /DKRS	Transmetimi idrejpërdrejt aktiviteteve te manifestimit “Flakadani i Karadakut 2021”, nga Smart Media SH,P. K. (Plus TV)	2,347.84 €
Totali:		9,778.84€

b). Tabela krahasuese 2020/2021


<i>“Flakadani i Karadakut 2020”</i> <i>(COVID -19)</i>	<i>Flakadanii Karadakut 2021”</i> /	
		9,778.84 €

IV. MBËSHTETËSIT E MANIFESTIMIT

Mbështetësit: Komuna e Vitisë.

Mediat: Manifestimi Tradicional kulturor dhe sportiv "Flakdani i karadakut 2021", u mbulua tërsisht nga "Plus Televizion", "Radio Televizioni i Kosoves", "TV Presheva", Zyra për Informim e Komunës së Vitisë, Radio Zëri i Pozheranit etj.

Viti, Prill 2021




Drejtori i DKRS:

Milot Lala



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipal Vitian

Nga: Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural

Për: Kuvendin Komunal Viti

Lënda: INFORMATË MBI PËRGATITJEN E TË MBJELLURAVE PRANVERORE

Komuna e Vitisë është njëra ndër komunat me sipërfaqe të madhe të mbjellurave me kultura të ndryshme bujqësore në Kosovë. Edhe pse gjendemi në kohë pandemie ne së bashku me zyrtarët e Drejtorisë së Bujqësisë jemi duke i kryer të gjitha aktivitetet sikurse më parë.

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural për çdo vit harton planet operative të mbjelljeve vjeshtore dhe pranverore, kun në bazë të këtyre planeve parashef sipërfaqet që do të mbjellen me kultura të ndryshme bujqësore. Andaj edhe gjatë këtij viti DBPZHR ka hartuar planin e mbjelljeve pranverore, ku ka paraparë sipërfaqet që do të mbjellen për çdo kulturë bujqësore.

Përveç planit të mbjelljeve DBPZHR ka vizituar të gjitha pikat shitëse të imputeve bujqësore për të parë se sa janë të furnizuara me impute bujqësore dhe kanë konstatuar se janë të furnizuara mjaftë mirë me impute bujqësore dhe fermerët tanë munden të furnizohen në këto pika me impute bujqësore.

Po ashtu zyrtarët e drejtorisë kanë bërë vizita në teren ku kanë parë nga afër përgatitjen e fermerëve për mbjelljen e kulturave pranverore dhe në bazë të vizitave në teren mbjelljet kanë filluar në afatin optimal dhe janë duke vazhduar mbjelljen.

DBPZHR – ka planifikuar të mbillen me kultura këto sipërfaqe:

Misër – 3235/ha, Misër i gjelbër-138/ha, Patate-130/ha, Perime-504/ha, Livadhe natyrore- 635/ha, Bari I mbjellur- 75/ha, Jonxhë- 85/ha, Tërfil-30/ha, Elb pranveror-5/ha, Tërshërë- 11/ha, Djerrinë-200/ha.

Rendimenti i planifikuar për hektar – Misër- 6500/kg

Rendimenti i planifikuar për hektar – Misër I gjelbër – 45,000/kg

Rendimenti i planifikuar për hektar- Patate – 38,000/kg

Rendimenti i planifikuar për hektar – Perime – 32,000/kg

Rendimenti i planifikuar për hektar Livadhe natyrore- 6000/kg

Rendimenti i planifikuar për hektar – Bari I mbjellur – 7,500/kg

Rendimenti i planifikuar për hektar – Jonxhë – 8,500/kg

Rendimenti i planifikuar për hektar – Tërfil – 700/kg


Rendimenti i planifikuar për hektar- Elb pranveror – 2,800/kg

Rendimenti i planifikuar për hektar –Tërshërë- 2,500/kg

Datë: 13.04.2021

Viti

Drejtore e Bujqësisë
Arlinda Sahiti





Republika e Kosovës

Komuna e Vitisë

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural

Nr. 10

Datë: 13.04.2021

VITI

PLANI OPERATIV PËR MBJELLJET PRANVERORE PËR VITIN 2021 NË SEKTORIN PRIVAT

Kultura	Sip. E planifikuar për /ha	Rendimenti i planif. për /ha	Gjithësej rend. I plan, në /ha	Sasia e farës për /ha	Gjithësej sasia e farës për /ha	Sasia e plehut për /ha	Sasia e NPK dhe NAG 50%/50	Lëndë djegëse për /ha	Gjithësej lëndë djegëse për / ha	Përgj
Misër	3235	6500/ kg	21,027,50 0 / kg	20 / kg	64,700/ kg	400/ kg	1,294,000 / kg	45 / L	145,575 / L	64.08
Misër i gjelbërt	138	45000/ kg	6,210,000/ kg	30 / kg	4,140 / kg	400 / kg	55,200/kg	45 / L	6,210 / 1	2.73
Patate	130	38000/ kg	49,400,00 0 / kg	1800/ kg	234,000 / kg	800/ kg	104,000/ kg	45 / L	5.850/ L	2.57
Perime	504	32000/ kg	16,128,00 0 /kg			600/ kg	302,400/ kg	45 / L	22,680 / L	9.98
Livadhe natyrorre	635	6000 / kg	3,810,000 / kg			400/ kg	254,000 / kg	30/L	19,050/L	12.57
Bari i mbjellur	75	7500 / kg	562,500 / kg	50 / kg	3,500 / kg	400 / kg	30,000 / kg	45 / L	3,375 / L	1.48
Jonxhë	85	8500 / kg	722,500 / kg	50 / kg	4.,250 / kg	300 / kg	25,500 / kg	30 / L	2,550 / L	1.68
Tërfil	30	700 / kg	21,000/ kg	50 / kg	1,500/kg	300 / kg	9 000/kg	30 / L	900/ L	0.59
Elb pranveror	5	2800 / kg	14,000 / kg	250 / kg	1,250/ kg	400 / kg	2,000/ kg	45 / L	225 / L	0.09
Tërshtëre	11	2500 / kg	27,500/ kg	250 /kg	2,750/ kg	400/kg	4,400 / kg	45 / L	495/L	0.21
Djerrinë	200									3.96
	5048									99.9